

VENDIM
Nr. 111, datë 15.2.2012

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SHITESË TË KONCESIONIT “PËR NJË NDRYSHIM NË
KONTRATËN E KONCESIONIT TË FORMËS “BOT”, TË LIDHUR NDËRMJET
MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE SHOQËRISË
“AURORA KONSTRUKSION” SHPK, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT VLUSHË,
MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 713, DATË 21.5.2008 TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21 pika 4, e 27 të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës shtesë të koncesionit “Për një ndryshim në kontratën e koncesionit të formës “BOT”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “Aurora Konstruktion” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentralit Vlushë, të miratuar me vendimin nr. 713, datë 21.5.2008 të Këshillit të Ministrave”.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha